

30.03.2018



C.nr.364/17

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ, Departamenti Pergjithshem- Divizioni Civil, gjyqtari Bekim Salihu, me bashkëpuntoren profesionale Kreshnike Zymberi, në çështjen juridiko-civile sipas padisë së paditëses Kompania e Sigurimeve '██████████' me seli Prishtinë rr. '██████████' nr. ████████ të cilën e përfaqëson me autorizim ██████████ jurist nga Prishtina, kundët të paditurit ██████████ nga Shtimja rr. '██████████', në çështjen juridike rimbursim dëmi, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 10.01.2018, kurse me 31.01.2018 perpiloi këtë:

AKT GJYKIM

- I. APROVOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditëses Kompania e Sigurimeve '██████████' me seli Prishtinë, rr. '██████████' nr. ████████ si e bazuar.
- II. DETYROHET** i padituri ██████████ nga Shtimja rr. '██████████', që paditëses t'i paguan shumën prej **1,300.00€** (njëmijë e treqind euro), në emër të rimbursimit dëmit, me kamatën ligjore nga data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 30€, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Arsy e t i m i

Përfaqësuesi i paditëses në fjalën e tij ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë duke shtuar se me qenë se nuk është kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë dhe se shkaktar i këtij aksidenti është i padituri ██████████ i njejtë ditën e shkaktimit të aksidentit nuk ka poseduar patentë shofer, kjo është vërtetuar edhe me raportin policor, në bazë të nenit 3 të LSDA e njohin të drejtën e rimbursimit të mjeteve nga pala paditëse, sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, e njejtë është vërtetuar me marrëveshjen jashtëgjyqësore me të dëmtuarin ██████████, andaj kanë kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesë padia e paditëses dhe të obligohet i padituri të paguaj shumën prej 1300€ në emër të regresit si dhe kamatën ligjore duke filluar nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit deri në pagesën definitive, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata për këtë çështje ka caktuar seancën e shqyrtimit të çështjes për të cilat seanca i padituri ka qenë i ftuar me rregullë, por asnjëherë nuk ka prezentuar në seancë, sipas propozimit të paditëses gjykata ka aprovuar mbajtjen e seancës në mungesë të të paditurit, pasi që i njejt i ka qenë i ftuar me rregullë, mungesën nuk e ka arsytuar si dhe shtyrjen nuk e kishte kërkuar.

Gjykata për ta vërtetuar drejt gjendjen e fakteve ka bërë administrimin e provave: *Raportin e aksidentit 2016-AU-468 i datës 25.12.2016, Procesverbalin mbi dëmtimin e automjeteve i datës 28.12.2016, Shiqohet librezja e automjetit BMW 701 nga shtetit Gjerman si dhe fotot e automjetit të dëmtuar, Vlerësimi i dëmtimit të automjetit me numër të lëndës 2076/16/01 i datës 06.01.2017, Marrëveshja jashtëgjyqësore 2076/16/01 i datës 25.01.2017, Kërkesa për kompensimin e dëmit material i datës 28.12.2016, Fatura e pagesës së dëmit në Bankën TEB i datës 03.02.2017.*

Gjykata pasi, ka bërë administrimin e provave një nga një dhe të gjitha s'bashku, në kuptim të nenit 8 të LPK-se, ka gjetur se kërkesë padia e paditëses është e bazuar.

Gjykata me rastin e vlerësimit të bazueshmërisë së kërkesëpadisë, së paditëses konsideron se e njëjta bazohet në provat e e administruara dhe atë ku është konstatuar se deri te aksidenti ka ardhur me lëshimet e automjetit BMW 320, të cilën ka qenë duke e vozitur tani i padituri e cila veturë ka pasur polisë të sigurimit mirëpo i njejt i në momentin e shkakimit të aksidentit nuk ka pasur patentë shofer, mbi këtë bazë paditëses i njhet e drejta e rimbursimit të dëmit, kurse sa i përket lartësisë së kërkesë padisë gjykata e ka bazuar në marrëveshjen jashtëgjyqësore të lidhur në mes të dëmtuarit në atë aksident dhe paditëses.

Me marrëveshjet jashtëgjyqësore të lidhura nga tani paditësja me të dëmtuarit e këtij aksidenti, paditësja, sipas urdhër transferit të datës 03.02.2017, të dëmtuarit i janë transferuar mjetet monetare ne emer te kompensimit të dëmit material, me të cilat transfere rezulton se paditësja e ka përmbushur detyrimin e saj sipas marrëveshjesë jashtëgjyqësore të lartë cekura, e në bazë të së cilës tani kërkon që të njëjtat të i rimbursohen nga i padituri.

Gjykata lidhur me lartësinë e dëmit material ka vendosur sipas vlerësimit të lirë në kuptim të nenit 323 LPK-së dhe në dispozitat e neni 136, 140 dhe 170 të LMD-së dhe rregullit 3 të BQK lidhur me nenin 14 par.1 pik 1.2 të Ligjit për Sigurimet e Detyrueshme, sepse i padituri në momentin e shkakimit të aksidentit nuk ka poseduar patentë shoferin, mbi këtë bazë e humbë mbulesën e sigurimit dhe nga kjo rrjedh detyrimi i të padituritë për rimbursimin e dëmit të paguar

nga paditësja si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës.

Gjykata në lartësinë e aprovuar të regresit të dëmit, paditëses ja ka njohur të drejtën në kamatë ligjore prej ditës së nxjerrjes së aktgjykimit me datën 31.01.2018 deri në pagesën definitive në kuptim të nenit 378 të LMD-së.

Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka bazuar në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, andaj i padituri obligohet që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 30€.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.364/17, me datën 31.01.2018



Gjyqtari
Bekim Salihu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROŠEVAC

1. 04 20 18